

STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MEDALJON” sh.p.k.

Sot ne daten **01.09.2025** , un ortaku themelues :

Z. Erion Stojani shtetas shqiptar , i datelindjes **25.07.1997**, atesia Gjet, lindur ne Tirane , banues ne Durres, i pajisur me pashaporte nr **BR2042729** dhe me nr personal **J70725082E**, leshuar me date **13.06.2017**, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare, hartoj Statutin e Shoqerise : **“MEDALJON” sh.p.k.** si me poshte:

NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet **“MEDALJON” sh.p.k.** dhe eshte person juridik shqiptar

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008 si edhe Ligjit per QKR-en.

NENI 2
SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne: **DURRES Lagjja Nr.8, Rruga " Aleksander Goga", Pasuria Nr 2/1176-N2, Zona kadastrale 8511, Pallati"ALBET "**
Shoqeria mund te krroje filiale ,zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryej aktivitet si me poshte :

Klinike stomatologjike. Sherbime te pergjithshme stomatologjike : Terapi Dentare, Kirurgji, Periodontologji, Protetike, Edukim per higjenen orale, Pediatria Dentrare, Radiologjia Dentare. Dhe sherbime Stomatologji Kozmetike : Implante Dentare, Fasetat Dentare, Kurorat dhe Urat Dentare, Pastrimi dhe Zbardhimi profesional me lazer, Fasetat e Kompozitit, Ortodonci.

NENI 4
KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise **“MEDALJON” sh.p.k** eshte **500.000 (pesqindmije) leke**



Ky kapital perbehet nga 1 kuota dhe zoterohet nga :

- 1. Z. Erion Stojani qe zoteron 100 % te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren 500.000 leke.**

NENI 5

MENYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet

- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- Shitblerjes
- Trashegimise
- Dhurimit
- Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

NENI 6

ZMADHIMI E ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar te votave.

NENI 7

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

NENI 8

ORGANET E SHOQERISE

Asambleja e Pergjithshme

Administratoret



NENI 9
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujdueseve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likujduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

NENI 10
MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME. MENYRA E THIRRJES

Mbledhja e asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme

Asambleja e Pergjithishme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te Ligjit

Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori te pakten 1 here ne vit,per miratimin e llogarive te shoqerise,por mbledhje te tjera mund te thirren gjate vitit per ceshtjet nga me te ndryshmet.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes se mesiperme, ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem ne se te gjitha ortaket jane dakort, per te marre vendime pamvaresisht parregullsise.



Kuorumi

-Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne se marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ketij ligji, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem ne se ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave qe jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

-Ne se asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur ne piken 1 te ketij neni, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejten rend dite.

Marrja e vendimeve

-Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te larte, asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarrjes, sic percaktohet ne piken 1 te nenit 86 te ketij ligji, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj ose ne statut, per ceshtje te tjera te renditura ne nenit 81 te ketij ligji, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrjes.

-Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo me vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne ligj, ose ne statut, kushtezohen nga miratimi i ortakut perkates.

-Te gjitha vendimet e asamblese duhet te regjistrohen ne proces verbal.

NENI 11

E DREJTA E VOTES

Cdo kuote i jep ortakut te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar te drejten e nje vote.

Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme ne se nuk ka shlyer teresisht detyrimet, qe kane te bejne me kuotat, qe ai disponon.

NENI 12

ADMINISTRATORET.

Administrator i shoqerise do te jete Z. Erion Stojani shtetas shqiptar , i datelindjes 25.07.1997, atesia Gjet, lindur ne Tirane , banues ne Durrës, i pajisur me pashaporte nr BR2042729 dhe me nr personal J70725082E, leshuar me date 13.06.2017, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte ripërteritje.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga Asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.



NENI 13

Kompetencat e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet :

-Te kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise,duke zbatuar politika tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.

-Te perfaqesoje shoqerine tregtare

-Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.

-Te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaj bilancin parashikues per vitin e ardhshem,per tu miratuar nga Asambleja e pergjithshme,brenda dates 20 tetor te vitit paraardhes.

-Te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaj bilancin vjetor te mbyllur, per tu miratuar nga asambleja e pergjithshme, brenda dates 20 Mars te vitit ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqit keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

-Te krijoje nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

-Te kryej regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise.

-Te raportoje perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

-Te kryej detyra te tjera,te percaktuara ne ligj dhe statut.

NENI 14

Shperndarja e fitimit vjetor te shoqerise

Pjesa e fitimit qe i takon seicilit ortak nga vlера e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise,vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese te fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 15

Prishja e shoqerise, largimi dhe perjashtimi i ortakeve

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :



- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b)me vendim te asamblese se pergjithshme
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit
- c)nese nuk ka kryer veprime tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 per "QKR".
- d)me vendim te gjykates
- dh)per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

Largimi i ortakut

- Ortaku mund te largohet nga shoqeria :
- nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij
- nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij.
- ne se shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo, per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

Perjashtimi i ortakut

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut, ne se ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve te statutit, ose ne se ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim, te parashikuar ne ligj.

NENI 16

Likujdimi i shoqerise

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likujdator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

NENI 17

Ftesa per kreditorët

Likujduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.



NENI 18**Perfundimi i likujdimit**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likujduesit nuk mund te kundershohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

NENI 19**MOSMARREVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kunder, ortakët themelues do ti drejtohen gjykates kompetente per zgjidhje.

NENI 20

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te behet referim ne dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar ne pergjithesi.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“MEDALJON” sh.p.k.

ERION STOJANI

